

DEMOKRACIA NA BËN TË LUMTUR



TË GJITHËVE

UDHËHEQJA E POPULLIT

DRILONA (11), MUHAMET (10) ELVEDINA (11), ELJESA (11), LAURENT (11), SARANDA (11), IMER (11),
MIRADIJE (10), ARBLIN (10)



Në demokraci, populli vendos për të tashmen dhe të ardhmen e shtetit

A keni dëgjuar ndonjëherë për fjalën demokraci? Fjala demokraci është fjalë që rrjedh nga gjuha greke, që në gjuhën shqipe do të thotë qeverisje e popullit. Demokracia është sistem i qeverisjes, që qytetarëve u jep të drejta të barabarta.

Pavarësisht fesë, racës, gjinisë, apo ndonjë karakteristike tjetër, që na dallon ne qytetarëve nga njëri-tjetri, në demokraci të gjithë jemi të barabartë. Demokracia shquhet për elementet të cilat i posedon. Këto elemente kanë vlerë të madhe, e që është mirë t'i kemi secili prej nesh. Në këto elemente bën pjesë barazia, e cila siç e cekëm më lart në demokraci është shumë e rëndësishme. Pastaj, është paqja që është e kundërta

e luftës. Kjo do të thotë se në një shtet demokratik të gjithë ndihemi të sigurt, pa frikën se do të na ndodhë diçka e keqe.

Përveç këtyre që i thamë, në demokraci vlerësohet edhe respektimi i njëri-tjetrit, ndihma që ne u ofrojmë të tjerëve, etj. Në Kosovë, të drejtën që na e mundëson demokracia e përdorim për t'i zgjedhur përfaqësuesit tanë. E kjo ndodh me anë të votave tona. Nga këto çka ne sot mësuam, ndamë me ju disa gjëra, të dashur lexues. Këtu në Punëtorinë për Demokraci „Demos-ti“ mësuam shumëçka për mënyrën e funksionimit të një shteti demokratik. Ne gjithashtu jemi ndjerë si në shtëpinë tonë, duke u shprehur lirshëm dhe duke u ndier të dashur. Pikërisht ashtu siç edhe e don demokracia.



Ne e duam demokracinë



Në demokraci, fuqia i takon popullit

INSTITUCIONI LIGJVËNËS I KOSOVËS

BLEONARDA (12), DAFINA (10), ELONA (10), ALBINOT (11), ENDRIT (11), AGNESA (11)



A dëshironi të dini më shumë për Kuvendin e Republikës së Kosovës? Ju lutemi lexojeni artikullin më poshtë dhe informohuni edhe më shumë për këtë institucion

Kush i miraton ligjet për popullin? Kësaj pyetje i kemi dhënë përgjigje në Punëtorinë e Demokracisë, ku mësuam se institucioni ligjvënës në Kosovë është Kuvendi i Kosovës. Kuvendi ka shumë detyra që duhet t'i kryej me shumë përkushtim. Njëra prej detyrave të Kuvendit është miratimi ose mos miratimi i ligjeve. Ligjet janë rregulla të shkruara, të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë. Disa nga ligjet që nxirren në Kuvend dhe që na ndikojnë neve nxënësve më së shumti janë: ligjet për arsimin, shëndetësinë, të drejtat e njeriut, etj. Kuvendi i Kosovës mundohet që të sigurojë mirëqenie sociale për të gjithë. Mënyra se si e bën këtë është duke i përfaqësuar kërkesat dhe interesat e popullit. Po ashtu, Kuvendi ka miratuar ligje, për të siguruar që shkollimi

fillor dhe i mesëm i ulët, të jetë i obliguar për të gjithë qytetarët që jetojnë në Kosovë, sepse shteti ka zhvillim më të madh kur qytetarët e saj janë të edukuar dhe të arsimuar. Kuvendi i Kosovës ka tri funksione: funksionin legjislativ, sepse Kuvendi propozon dhe miraton ligjet; funksionin përfaqësues, sepse deputetët të cilët punojnë në Kuvend e përfaqësojnë popullin; dhe funksionin kontrollues, sepse Kuvendi kontrollon Qeverinë, e cila i vë në zbatim ligjet e marra nga Kuvendi. Pra, Kuvendi është institucion mjaft i rëndësishëm për popullin, sepse çështjet më të rëndësishme për vendin diskutohen aty. Jemi shumë me fat që kemi pasur rastin të mësojmë për këtë institucion, dhe presim që edhe ju të mësoni sadopak. Së bashku mund t'i zbatojmë parimet e demokracisë dhe gjithmonë duhet bërë thirrje në këtë aspekt. Ne në demokraci kemi të drejtë të ndërtojmë të ardhmen tonë, prandaj bëhu edhe ti pjesë e ndërtimit të së ardhmes.



Kuvendi i zbaton parimet e demokracisë



Demokratët e së ardhmes

DEPUTETËT, PËRFAQËSUESIT E POPULLIT


VALDRIN (11), RINORA (10), VERONA (11), ERION (11), ALKETA (10), DONJETA (12)

Pse është e nevojshme që populli të zgjedh deputetët? Nga cila moshë e kemi të drejtën e votës? A kemi të drejtë të kandidojmë për deputetë? Përgjigjet mësoni në artikullin më poshtë

Kosova ka përafërsisht 2 milionë banorë. Për këtë arsye populli duhet të dal në zgjedhje, që të zgjedh përfaqësuesit e vet. Të drejtën për t'i zgjedhur përfaqësuesit e shtetit tonë e kemi nga moshja 18 vjeçare. Kjo ngase, në këtë moshë jemi më të pjekur dhe e dimë më mirë si duhet të jenë personat, të cilët do ta përfaqësojnë vendin tonë, Kosovën. Përveç që e kemi të drejtën për të zgjedhur, ne e kemi të drejtën edhe për të kandiduar për deputetë, kuptohet nga moshja 18 vjeçare. Këto të drejta sigurohen nga sistemi më i mirë i qeverisjes, që është demokracia. Pra, populli fuqinë që ka, ia jep deputetëve. Kurse, deputetët zgjedhin Presidentin. Kjo i bie se vota jonë ka vlerë të madhe në qeverisjen e vendit. Prandaj, bëhuni sa më shumë qytetarë aktiv.



Autorët e artikullit




Të gjithë kemi të drejtën për të zgjedhur



Këta janë kandidatët për deputetë



Nëse kandidatët për deputetë marrin shumë vota nga populli, ata do ta përfaqësojnë popullin



Kjo është pamja e brendshme e Kuvendit të Kosovës, institucionit që miraton ligjet

AKTIVISTËT

ALMEDIN (10), ALBIARD (10), ERBLIN (11), DONIKA (11), GZIMI (11), RINESA SH. (10), ERISA (11),
 BLEND A (11), RINESA M. (11)

Në këtë artikull flitet për qytetarët aktiv të shtetit tonë. Ne jemi anëtarët e grupit „Aktivistët“. Këtu kemi paraqitur mendimet tona për qytetarët aktiv. Lexim të këndshëm

Qytetarë aktiv janë të gjithë ata që ndihmojnë. Ata janë persona që respektojnë njëri-tjetrin, shtetin si dhe respektojnë rregullat. Prandaj, ne si qytetarë duhet respektuar rregullat. Mos hedhja e mbeturinave si dhe respektimi i ligjit, janë vetëm disa nga mënyrat se si ne mund të tregohemi qytetarë të përgjegjshëm. Çdo njeri ka të drejtë të shprehë atë që mendon, sepse të gjithë jemi të barabartë dhe të gjithë kemi liritë tona. Po ashtu, ne kemi të drejtën e votimit. Mirëpo, ne mund të votojmë lirshëm pasi ta arrijmë moshën 18 vjeçare. Edhe pse, ende nuk mund të votojmë, ne të gjithë kemi të drejtën e shkollimit, të drejtën e strehimit, etj.

Nëse ne dëshirojmë që në qytetin tonë të kemi një spital, ne mund të shënojmë një kërkesë. Këtë kërkesë e quajmë peticion.

Ne në klasën tonë kemi mbledhur të holla për t'iu ndihmuar nxënësve të varfër që të blejnë libra, fletore dhe mjetet e tjera që na nevojiten për mësim. Gjithashtu, ne iu ndihmojmë qytetarëve të varfër. Këtë e bëjmë duke iu dhënë rroba. Kjo është një ndihmë që mund t'iu ofrojmë qytetarëve në nevojë, sepse edhe ata janë të barabartë me ne. Për të qenë të shëndetshëm, ne mbledhim mbeturina dhe mbajmë qytetin tonë të pastër. Kjo sipas nesh është qytetaria aktive.



Spitali na ndihmon që të jemi të shëndetshëm dhe të lumtur



Grupi „Aktivistët“



Kur të mbushim 18 vjet do të votojmë edhe ne!



Ne kemi të drejtë të jetojmë në një ambient të pastër



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Akrashticë“
Klasa: V-1
Vendi: Vushtrri